

VENDIM
Nr. 683, datë 16.8.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, PËR
KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK ME DISA FONDE TË
MIRATUARA NË BUXHETIN E SAJ PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, si autoritet kontraktues, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik me fondet e miratuara në buxhetin e saj për vitin 2013, sipas listës në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

I. Fonde buxhetore për shpenzime kapitale

1. SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë:

a) “Rikonstruksion i sistemit të kondicionimit të bllokut operator të repartit të Obstetrisë”, me fond limit 4.300.000 lekë (me TVSH) ose 3.583.333 lekë (pa TVSH).

b) “Supervizion për rikonstruksionin e sistemit të kondicionimit të bllokut operator të repartit të Obstetrisë”, me fond limit 146.000 lekë (me TVSH) ose 121.666 lekë (pa TVSH).

c) “FV ashensor për pacientë për repartin e Gjinekologjisë”, me fond limit 10.000.000 lekë (me TVSH) ose 8.333.333 lekë (pa TVSH).

d) “Supervizion për FV ashensor për pacientë për repartin e Gjinekologjisë”, me fond limit 278.000 lekë (me TVSH) ose 231.666 lekë (pa TVSH).

2. Drejtoria e Spitalit Fier:

a) “FV aparat grafi për Poliklinikën e Spitalit Fier”, me vlere limit 5.000.000 lekë (me TVSH) ose 4.166.666 lekë (pa TVSH).

3. SUOGJ “Koço Gliozheni” Tiranë:

a) “Rikonstruksioni i ambienteve të katit III në godinën 6-katëshe (pathologjia e barrës)”, me fond limit 50.038.024 lekë (me TVSH) ose 41.698.353 lekë (pa TVSH). Fondi i çelur për vitin 2013 është 10.000.000 lekë (me TVSH)

b) “Supervizion për rikonstruksionin e ambienteve të katit III në godinën 6-katëshe (pathologjia e barrës)”, me fond limit 730.000 lekë (me TVSH) ose 608.333 lekë (pa TVSH).

4. Drejtoria e Spitalit Shkodër:

a) Blerje pajisje mobilimi për repartet e laboratorit dhe pneumo-ftiziollogjisë” me vlerë 1.200.000 lekë (me TVSH) ose 1.000.000 lekë (pa TVSH).

5. Drejtoria e Shëndetit Publik Gramsh:

a) “Rikonstruksion i Qendrës së Shëndetit Mendor”, me fond limit 3.000.000 lekë (me TVSH) ose 2.500.000 lekë (pa TVSH).

b) “Supervizion i rikonstruksionit të Qendrës së Shëndetit Mendor”, me vlerë 108.000 lekë (me TVSH) ose 90.000 (pa TVSH).

6. Drejtoria e spitalit psikiatrik Vlorë”

a) “Supervizion për ndërtimin e spitalit të ri psikiatrik Vlorë”, me fond limit 1.980.000 lekë (me TVSH) ose 1.650.000 lekë (pa TVSH).

7. Procedura prokurimi të përqendruara në Ministrinë e Shëndetësisë janë:

“Blerje unit dentar për institucionet e varësisë”, sipas tabelës së mëposhtme, me vlerë totale limit 10.400.000 lekë (me TVSH) ose 8.666.666 lekë (pa TVSH).

DSHP Bulqizë	700.000	Blerje unit dentar për DSHP (copë 1)
DSHP Durrës	700.000	Blerje unit dentar për DSHP (copë 1)
DSHP Gramsh	700.000	Blerje unit dentar për DSHP (copë 1)
DSHP Kavajë	1.400.000	Blerje unit dentar për DSHP Kavajë (copë 2)
DSHP Kuçovë	700.000	Blerje unit dentar për DSHP (copë 1)
DSHP Lezhë	700.000	Blerje unit dentar për DSHP (copë 1)
DSHP Laç	700.000	Blerje unit dentar për DSHP (copë 1)
DSHP Mallakastër	700.000	Blerje unit dentar për DSHP (copë 1)
DSHP Përmet	700.000	Blerje unit dentar për DSHP Përmet (copë 1)
DSHP Pogradec	1.400.000	Blerje unit dentar për DSHP (copë 2)
DSHP Tropojë	2.000.000	FV aparat digjital stomatologjik për kl. dentare DSHP Tropojë

8. Procedurë e përqendruar në Ministrinë e Shëndetësisë është:

“Blerje pajisje mjekësore dhe laboratorike për DSHP-të”, sipas tabelës në vijim, me fond total limit 20.964.000 lekë (me TVSH) ose 17.470.000 lekë (pa TVSH).

DSHP Gramsh	420.000	Blerje pajisje mjekësore
DSHP Kavajë	504.000	Blerje pajisje mjekësore
DSHP Krujë	2.000.000	Blerje pajisje mjekësore
DSHP Lushnjë	2.300.000	Blerje pajisje mjekësore
DSHP Shkodër	909.000	Blerje pajisje mjekësore
DSHP Tropojë	480.000	Blerje pajisje mjekësore
DSHP Berat	1.000.000	Pajisje mjekësore për laboratorët e shëndetit publik Berat
DSHP Bulqizë	1.500.000	Blerje pajisje mjekësore për laboratorët
DSHP Delvinë	2.400.000	Blerje aparatura laboratorike DSHP Delvinë
DSHP Dibër	1.841.000	Blerje pajisje mjekësore për laboratorët DSHP Dibër
DSHP Kolonjë	2.800.000	Blerje pajisje mjekësore për laboratorët DSHP Kolonjë
DSHP Kuçovë	1.400.000	Blerje pajisje laboratorike për DSHP Kuçovë
DSHP Shkodër	1.000.000	Blerje pajisje mjekësore për laboratorët
ISHP Tiranë	2.410.000	Blerje pajisje-aksesorë për stacionarët e monitorimit të ajrit ISHP

II. Shpenzime korente me objekt:

a) Blerje materiale kancelarie për QSUT, me fond limit 1.266.630, pa TVSH dhe 1.519.956, me TVSH.

b) Blerje shtypshkrime për SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”.

- c) Blerje materiale pastrimi për Spitalin Rajonal Berat.
- d) Blerje materiale pastrimi për QSUT, me fond limit 1.051.000 pa TVSH dhe 1.261.200 me TVSH.
- e) Blerje materiale pastrimi për Spitalin Rajonal Lezhë, me fond limit 833.325 lekë, pa TVSH.
- f) Blerje detergjent për Spitalin Lushnjë, me fond limit 1.700.000 lekë, me TVSH.
- g) Riparim mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe ujit sanitar me kaldaja, stacionit qendror të pompave të ujit në QSUT, me fond limit 2.476.500 pa TVSH dhe 2.971.800 lekë, me TVSH.
- gj) Riparim mirëmbajtje e sistemit të furnizimit me energji elektrike, sistemit të orëve dhe diktimit-sinjalizimit të zjarrit, QSUT, me fond limit 3.835.000 lekë, pa TVSH dhe 4.602.000 lekë, me TVSH.
- l) Shërbimi i ruajtjes dhe i sigurisë fizike të objekteve në QSUT, me fond limit 14.464.000 lekë, pa TVSH dhe 17.356.800 lekë, me TVSH.
- ll) Shtesë kontrate QSUT, për “Trajtimi me dializë i pacientëve të sëmurë me insuficiencë renale kronike, referuar nga Shërbimi i Nefrollogji-hemodializës pranë QSUT, me shoqërinë Univers -Alb” sh.a., me fond limit 38.658.816 lekë, pa TVSH dhe 46.390.580 lekë, me TVSH.
- m) Shtesë kontrate QSUT për “Trajtimi me dializë i pacientëve të sëmurë me insuficiencë renale kronike, referuar nga Shërbimi i Nefrollogji-hemodializës pranë QSUT, me bashkimi i operatorëve ekonomikë diagnostik dhe Therapeutik Center of Athens Hygeia S.A.” dhe Hygeia Hospital Tirana” sh.a. shoqërinë Univers-Alb” sh.a., me fond limit 17.464.186 lekë, pa TVSH dhe 20.464.186 lekë, me TVSH.
- n) Zhvillimi i informatizimit të mëtejshëm në QSUT nëpërmjet sistemit të informacionit SIPS (kartela e pacientit spitalor), me fond limit 20.584.000 lekë, pa TVSH dhe 24.700.800 lekë, me TVSH.
- o) Riparim pajisje mjekësore FV aksesorësh dhe pjesë këmbimi përkatëse për to në QSUT, me fond limit 3.261.775 lekë, pa TVSH dhe 3.914.130 lekë, me TVSH.
- p) Riparimi i autobotit për furnizimin me karburant të helikopterëve të NJTMH, me fond limit 3.616.444 lekë, pa TVSH.
- q) Blerje materiale të buta për Spitalin Psikiatrik Vlorë, me fond limit 9.209.448, me TVSH.
- r) Nënkontraktimi i shërbimit të luanterisë në Spitalin Rajonal Lezhë, me fond limit 22.238.125 lekë, pa TVSH.
- s) Blerje lëndë djegëse për ngrohje (briket pellet), për shërbimin spitalor Librazhd, me fond limit 1.931.635 lekë, me TVSH.
- t) Shërbimi me rojë private për SUOGJ “Koço Gliozheni”, me fond 2.332.642 lekë, pa TVSH.
- v) Blerje gaz heliumi i lëngshëm dhe kalibrim pas mbushjes i aparaturës së rezonancës manjetike, në Spitalin Rajonal Durrës, me fond limit 3. 236.000 lekë, pa TVSH.
- z) Riparim i pajisjes CT-Scanner të Spitalit Rajonal Durrës, me fond limit 600.000 lekë, pa TVSH.